

Letër e Hapur

të gjithë institucioneve ndërkombëtare të përfshira në mbështetjen e inkurajimin e Reformës në Drejtësi dhe

5 PYETJE Institucioneve Ndërkombëtare:

KUSH DHA URDHËR TË PENGJË REGJISTRIMIN NË 25 KORRIK TË “LËVIZJES POLITIKE SHPRESON” NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN DHE KUSHTETUTËN?

(Sipas Nenit 24 të Ligjit për Regjistrimin e OJFve nr 8789, datë 7.5.2001 dhe Nenit 31 të Ligjit nr 80/2021, Lëvizja ShpresON duhej të regjistrohej brenda 15 ditësh nga data e dorëzimit të kërkesës në Gjykatë në 10 Korrik 2023)

Është Qeveria që nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe heshtjen e KLGJ dhe Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë (megjithë 3 ankesat e bëra përgjatë 10 ditëve të fundit) dhe bllokuan në heshtje duke shkelur afatin ligjor prej 15 ditësh për shpalljen e vendimit për regjistrimin e Shoqatës “Lëvizja Politike ShpresON” që duhet të ndodhte dhe në dt 25 Korrik 2023 ndërkohë që urdhëri qeveritar kërkon ta shtyjë përtej Shtatorit, Tetorit apo nuk dihet kur, pikërisht për të favorizuar diversionet e tyre për të kontrolluar pakënaqësinë dhe përfaqësimin qytetar.

A po bëhet kjo për të favorizuar në afate kohore regjistrimi juridik në Shtator të një Lëvizje të re, e deklaruar publikisht nga personi i prezantuar në emër të saj Z. Adriatik Lapaj në 18 Korrik (që promovohet në çdo media të afërt me Kryeministrin Edi Rama apo Kryetarin e Bashkisë Erion Veliaj)?

Sot u shkel hapur pavarësisht paralajmërimeve tona Neni 43 i Kushtetutës, Neni 24 i Ligjit për Regjistrimin e OJFve të vitit 2001 dhe Neni 31 i vitit 2021.

Përkatësisht:

Neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë:

1. ***“Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.”***
2. ***“Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj.”***
3. ***“Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit”.***

Neni 24 i Ligjit Nr. 8789, datë 7.5.2001

“Vendimi i gjyqtarit”

1. ***“Gjyqtari vendos për kërkesat e regjistrimit ose të depozitimit, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës në gjykatë.”***
2. ***“Në rastin kur gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe të dokumentacionit të bashkëlidhur, gjyqtari vëren se përmbajtja e tyre nuk është e plotë, pasi thërret dhe dëgjon kërkuuesin, vendos për çështjet që duhen plotësuar, duke caktuar edhe një afat të arsyeshëm për plotësimin e tyre.”***

Neni 31 i Ligjit për regjistrimin e OJFve nr 80 i viti 2021

“Vendimi i gjyqtarit”

1. ***“Gjyqtari, me përjashtim të rasteve kur ka pezulluar shqyrtimin e kërkesës sipas nenit 29 të këtij ligji, vendos për kërkesat e regjistrimit ose të çregjistrimit në dhomë këshillimi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e depozitimit të kërkesës në sekretarinë e regjistrimit ose në formë elektronike.”***

Lëvizja Politike ShpresON

Reforma në Drejtësi a i ka kthye gjykatat në instrumenta bllokimi për krijimin e organizatave opozitare për të favorizuar lindjen e spinoff-eve të reja liberale që sponsorizohen për të dominuar narrativën dhe aksionin opozitar?

Sot Gjykata e Tiranës me urdhër të Qeverisë pengon dhe bllokon, duke shtyrë në kohë të panjohura, regjistrimin e organizatës “Lëvizja Politike ShpresON” duke shkelur afatet detyruese proceduriale taksative 15 ditore.

KUJT I DREJTOHET KJO LETËR:

Letër e Hapur të gjitha institucioneve dhe organizateve ndërkombëtare dhe lokale të përfshira në promovimin e Reformës në Drejtësi dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive politike:

- *Institucioneve ndërkombëtare dhe përfaqësive diplomatike të përfshira në mbështetjen e hartimit të Reformës në Drejtësi dhe të atyre që po mbështesin zbatimin e kësaj Reforme*
- *Organizatave lokale dhe ndërkombëtare që mbrojnë Lirinë dhe të Drejtave të Njeriut dhe atyre që mbështesin demokracinë dhe pjesmarrjen publike në vendimarrje*
- *Mediave lokale dhe atyre ndërkombëtare*
- *Organizatave politike të djathta në Europë dhe SHBA*

5 Pyetje institucioneve ndërkombëtare që promovojnë Reformën në Drejtësi:

Cilat nga këto ishin qëllimet e Reformës në Drejtësi?

- 1. Garantimi i të drejtave të barabarta kushtetuese të qytetarëve për të mos u diskriminuar politikisht dhe tu njihet e drejta për tu organizuar “kolektivisht për çfarëdo qëllimi i të ligjshëm” apo përdorimi i gjykatave për ti penguar qytetarët të organizohen për shkak të qëndrimeve të tyre politike.**
- 2. Shpëtimi i Drejtësisë nga korrupsioni apo kthimi i Gjykatave në pishqolla partizane antikushtetuese të Qeverisë për të eliminuar aktorët dhe faktorët politikë dhe qytetarë opozitarë për ti hapur rrugë diversioneve të pushtetit në politikë dhe shoqërinë civile?**
- 3. Garantimi i të drejtave politike të barabarta për çdo qytetar apo trajtimi me dy standarde i qytetarëve sipas preferencave politike të Qeverisë?**
- 4. Regjistrimi i organizatave politike brenda afateve 15 ditore që përcakton Legjislacioni Shqiptar në mënyrë taksative apo bllokimi i tyre arbitrar në heshtje, pa asnjë procedurë, vendim, njoftim apo shpjegim, i regjistrimit të organizatave të papëlqyera nga Qeveria për ti hapur rrugë regjistrimit në kohë të organizatave që shpik ajo për të dominuar narrativën opozitare dhe penguar ato që nuk kontrollohen nga Establishmenti qeveritar?**
- 5. Krijimi i instrumentave të pavarura të gjyqësorit (KLGJ) dhe inspektimit të drejtësisë (Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë) për të garantuar zbatimin e ligjit procedural dhe administrativ apo një sistem garancie qeveritare për të mos penguar madje inkurajuar kthimin e gjykatave në armë politike për të penguar qytetarët të organizohen në mënyrë që të favorizohen në kohë krijimi i spin-off-eve që pjell Pushteti?**

Shpjegimi i skandalit politik të sotshëm

dhe përfshirjes politike së drejtëpërdrejtë si instrument partiak i sistemit të drejtësisë të reformuar nga “Reforma në Drejtësi” dhe e promovuar si sukses ndërkombëtar.

12 qytetarë shqiptarë të inkurajuar nga një grupim më i gjerë prej 38 personash themeluan në dt 5 Korrik 2023 konform ligjit Shoqatën “Lëvizja Politike ShpresON” pas 6 javësh diskutimesh dhe shkëmbim idesh me qëllime të qarta për të inkurajuar pjesmarrjen e qytetarëve në vendimarrje për shkak të refuzimit masiv të një pjese të elektoratit shqiptar për tu përfaqësuar me votë në Zgjedhjet Lokale të 14 Majit.

Një ndër objektivat më të shpejta dhe urgjente ishte dhënia e kontributit në Reformën Zgjedhore që nis në Shtator 2023 dhe përballja me gjëndjen e rënduar të pesimizmit dhe trendit në rritje për largim nga Shqipëria për shkak të Axhendës së Shpopullimit të Shqipërisë që po zbatohet nga Qeveria nën impotencën e plotë politike të një opozite të përçarë dhe në dekadencë. Ata paraqitën kërkesën sipas ligjit në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë në dt 10 Korrik 2023 dhe sipas parashikime ligjore ata deri në dt 25 Korrik 2023 duhet të pajiseshin me vendimin e Regjistrimit apo me kthimin e dokumentave për plotësim (sipas gjykimit të gjyqtarit të vetëm) nëpërmjet të njëjtave afate për plotësim nga kërkuesit dhe për shpallje nga gjykata.

Megjithë paraqitjen e përditshme zyrtare pranë Gjykdhe për të marrë informacion dhe paraqitjen e 3 ankesave (1. Drejtuar Kancelarit dhe për dijeni Krytearit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë në 14 Korrik 2023, 2. Drejtuar Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë në dt 17 Korrik 2023, Drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor në dt 20 Korrik 2023) ku theksonim detyrimin për respektimin e afateve ligjore dhe sabotimit zyrtar që po i bëhej respektimit të afateve, sot në dt 25 Korrik 2023, Gjykata pa asnjë transparencë dhe në kundërshtim me ligjin nuk realizoi asnjë seancë

Lëvizja Politike ShpresON

gjyqësore për dhënien e vendimit apo kthimit për plotësim të dokumentave të Shoqatës Lëvizja Politike ShpresON.

Kujtojmë se në dt 19 Korrik 2023, aktivistët e Lëvizja Politike ShpresON, konform ligjit dhe të drejtës së qytetarëve për të shprehur të lirë idetë dhe pikëpamjet e tyre, dhanë njoftimin në rrjetet sociale se Lëvizja Politike ShpresON niste turin e debateve me qytetarët duke filluar me Tiranën me Bashkëbisedimin e parë publik në Amfiteatrin e Universitetit të Arteve në dt 26 Korrik 2023 në 20:00 me temë “Jemi të Papërfaqësuar sepse jemi të Pashpresë apo Jemi të Pashpresë sepse jemi të Papërfaqësuar”.

Pas disa orësh por në atë datë, një ndër ishpunonjësit dhe grantmnarrësit e Fondacionit Soros Z. Adriatik Lapaj (që promovohet prej 15 Majit 2023 në të gjitha TV që janë publikisht në influencën e drejtëpërdrejtë të Kryeministrit Edi Rama apo Kryetarit të Bashkisë Tiranë Erion Veliaj) shpalli në media strategjinë e Lëvizjes Politike që ai dhe individë të tjerë (të angazhuar apo mbështetur me Fondacionin Soros përgjatë periudhës 2010-2023), disa orë më vonë u paraqit në një media dhe tregoi strategjinë e tij që në Shtator 2023 do të paraqiste në Gjykatën e Tiranës një Kërkesë për regjistrimin e Lëvizjes Politike si një shoqatë politike.

Qartas, pengimi antikushteues dhe antiligjor i regjistrimit të Shoqatës Lëvizja Politike ShpresON, (si një organizatë e cila themelohet nga aktivistë të njohur për qëndrimet e tyre publike kundër influencës së Soros në politikën dhe ekonominë shqiptare madje edhe si ideator dhe sponsorizues i Axhendës për Shpopullimin e Shqipërisë) nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i lë shteg regjistrimit të mëhershëm të një organizate politike që promovohet nga Qeveria dhe Fondacioni Soros dhe pengon institucionalizimin ligjor dhe fiskal për të penguar rritjen dhe fuqizimin e e Lëvizja ShpresON për ti dhënë avantazh spin-off-eve të rrjetit Soros që hidhen në treg për të diversionuar krijimin e opozitave që pretendojnë se do jenë djathtas (ndërkohë që mbështeten nga një

Network privat i Soros i cili akuzohet ndërkombëtarisht që sponsorizon të majtën dhe diversionon të djathtën).

Për këtë arsye ne kërkojmë ti kujtojmë të gjithë institucioneve ndërkombëtare të përfshira në inkurajimin dhe mbështetjen e Reformës në Drejtësi, se Reforma reale në Drejtësi nuk është ajo e paraqitur në raporte ndërkombëtare dhe media! Përkundrazi! Reforma reale në Drejtësi është kjo histori që po ndodh me shkeljen e parimeve më themelore kushtetuese dhe vetë legjislacionit shqiptar në mes të ditës për qëllime krejtësisht politike dhe të influencuara qartësisht nga Qeveria dhe networku privat Soros.

Ne kërkojmë t'ju informojmë se ju duhet të vlerësoni të vërtetën e Reformës në Drejtësi dhe pasojat e pallogaritshme që ajo ka krijuar në rënien e efikasitetit të proceseve gjyqësore, njëanshmërinë e theksuar, rënien e besimit të publikut, por mbi të gjitha edhe në kthimin e saj në një çomange të Qeverisë dhe aleatit të saj Networkut Privat Soros, i cili ka ideuar, ka influencuar, ka lobuar, ka draftuar dhe ka emëruar në postet kyçe të qeverisjes së gjyqësorit dhe nivelet më të larta kushtetuese dhe deri në Strasburg, njerëzit e promovuar nga ky Fondacion dhe sot ne qytetarët shqiptarë po trajtoheni në mënyrë diskriminuese politikisht në vendin tonë duke na u penguar e drejta ligjore e organizimit dhe funksionimit efektiv konform legjislacionit fiks, transparencës dhe mbi të gjitha të mbledhjes së fondeve për të fuqizuar lëvizjen tonë qytetare në dobi të interesit publik dhe sdms për të ringjallur shpresën se shqiptarët mund ta ndalojmë Axiendën e Shpopullimit të Shqipërisë ku sponsori kryesor i saj konsiderohet nga ne se është vetë Fondacioni Soros dhe njerëzit e tij të katapultuar në politikë, media, shoqërinë civile dhe gjithë sektorët dhe strukturat e hierarkisë shoqërore si një investim 31 vjeçar.

Ne si qytetarë do të vazhdojmë pa ndalesë aksionin tonë politik në dobi të shpëtimit të Shqipërisë dhe kujtojmë se 50 ditë më parë kemi vendosur bashkëpunim me një OJF shqiptare të regjistruar vite më parë, para se të

Lëvizja Politike ShpresON

aplikohej reforma në drejtësi, e cila do të na mundësojë aksesin ligjor dhe fiskal brenda objektivave dhe programit të saj, për aq kohë sa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të vazhdojë shkeljen e ligjit dhe sdms Nenit të Kushtetuës!

Të Mërkurën, dt 26 Korrik 2023, në 20:00, në Amfiteatrtin e Universitetit të Arteve, Ne themeluesit e Lëvizjes Politike ShpresON nisim turin e bashkëbisedimit me qytetarët shqiptarë në kushtet e censurës së stimuluar nën influencën e pushtetit dhe Networkut Soros, pavarësisht përpjekjes së Qeverisë dhe Netwrokut Soros për të na penguar për ti dhënë avantazhe spinofeve të reja të Soros njësoj siç bënë në 2003 në 15 Mars kur stimuluan Lëvizjen MJAFIT si hapi i parë për shkatërrimin dhe shkretimin e shoqërisë civile dhe më pas politikës dhe gjithë Shqipërisë!

Pengimi nga ana e Gjykatës do të detyrojë Lëvizjen Politike ShpresON të ndërmarrë të gjitha veprimet institucionale por edhe strategjinë e saj që konform ligjit të kapërcejë pengesat e Qeverisë dhe Networkut Privat Soros për të mbrojtur interesat e qytetarëve shqiptarë dhe krijuar rezistencë ndaj Axfordës së Shpopullimit të Shqipërisë duke rikthyer shpresën e vrarë nga politika.

Ndërkohë inkurajojmë institucionet ndërkombëtare dhe gazetarët që të verifikojnë çdo pretendim tonë dhe të investigojnë kapjen e sistemit të drejtësisë nga politika duke treguar të vërtetën për Reformën në Drejtësi përtej sponsorizimeve për të fshehur realitetin e hidhur të saj.

Faleminderit

Lëvizja Politike ShpresON

#ShpresON www.shpreson.al

Për të kontaktuar keni info@shpreson.al

Telefon dhe whatsapp për momentin +355 069 267 5817

Selia: Rr. Bardhok Biba, P.75, Sh.2, Nr 5, (Kati i Parë) Tiranë, Shqipëri

Bashkëngjitur keni:

1. Fotokopje e **Neni 46 të Kushtetutës** së Republikës së Shqipërisë
2. Fotokopje e **Neni 24 të Ligjit Nr. 8789**, datë 7.5.2001
3. Fotokopje e **Neni 31 të Ligjit për regjistrimin e OJFve nr 80 i viti 2021**
4. Kopjen e faqes së parë të **Kërkesës** për Regjistrim të Shoqatës Lëvizja Politike ShpresON në dt 10 Korrik bashkë me vulën e regjistrimit dhe Mandat Pagesën përkatëse.
5. Kopjen e faqes së parë të **Ankesës** të paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dt 14 Korrik 2023 bashkë me vulën e protokollit 4296
6. Kopjen e faqes së parë të **Ankesës** të paraqitur në Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë dt bashkë me faturën postare dhe kopjen e letërporosisë së postës që konfirmon marrjen.
7. Kopjen e faqes së parë të **Ankesës** së paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dt bashkë me vulën dhe nr e protokollit
8. Foto nga **websiti** i Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë që tregon se Gjyqtari Dritan Caka nuk ka lënë as datë dhe as ka zhvilluar ndonjë seancë gjyqësore për kërkesën për regjistrimin e Shoqatës “Lëvizja Politike ShpresON”.

Informacion i detajuar për median dhe institucionet për vijueshmërinë në 15 ditë: 10 Korrik - 25 Korrik 2023

Në dt 10 Korrik 2023 u paraqit pranë Gjykatës Tiranë sipas ligjit kërkesa dhe dokumentat noterial që përcakton ligji për regjistrimin e Shoqatës “Lëvizja Politike ShpresON” me nr protokolli 950 nga përfaqësuesit e Lëvizja ShpresON. Sipas afateve ligjore në dt 25 Korrik do të merrnim vendimin për regjistrim ose kthimin e dokumentave për plotësim brenda afatit dhe riparaqitjen e tyre për tu regjistruar brenda 15 ditësh nga paraqitja, pra vendimi për regjistrim do të ishte para 1 Shtatorit 2023 siç ishte parashikuar edhe nga themeluesit në kërkesë, pasi një nga objektivat më të shpejtë të themeluesve ishte edhe paraqitja institucionale e qytetarëve mbështetës për këtë lëvizje me propozime konkrete për Reformën Zgjedhore në 1 Shtator 2023.

Në dt 11 Korrik 2023 u paraqitën përfaqësuesit e ShpresON bashkë me kopjen e kërkesës së protokolluar dhe në KryeSekretarinë Gjyqësore dhe Zyrën e Informacionit nuk gjendej asnjë asnjë gjurmë e regjistrimit mgjiths duhet të ishte hedhur në sistemin informatik të gjykatës dhe duhej të ishte bërë shorti.

Në dt 12 dhe 13 Korrik 2023 ishte e njëjta situatë madje askush në Sekretati nuk ishte në gjëndje të tregonte se ku ndodheshin dokumentat pasi nuk figuronin askund dhe për këtë arsye u paralajmëruan nga përfaqësuesit e ShpresON se do të paraqitej një ankesë drejtuar kancelarit dhe për dijeni Kryetarit të Gjykatës për zhdukje të qëllim të dokumentave dhe pengim të afateve detyruese prej 15 ditësh për shprehjen me vendim të gjykatës sipas ligjit. Në dt 13 Korrik informohemi se kërkesa e paraqitur në dt 12 Korrik nga një organizatë politike SH.D. jo vetëm që ishte protokolluar por ishte futur në sistem ndërsa për organizatën tonë politike “Lëvizja Politike ShpresON” nuk kishte asnjë gjurmë në sistem dhe nuk ishte në gjëndje askush të tregonte se ku ishin dokumentat. Pra mënyra se si regjistroheshin kërkesat për organizatat ishte preferenciale.

Në dt 14 Korrik 2023 u paraqit kërkuesi i autorizuar i ShpresON në Kryesekretarinë dhe pas dështimit nga ana e Kryesekretares për gjetjen e gjurmëve të dokumentave u paraqit një ankesë (siç ndodhet në dokumentat bashkëngjitur) e cila u protokollua me vështirësi për shkak të hezitimit insistues të personelit. Në ankesë i kujtoheh Kancelarit dhe Kryetarit të Gjykatës se Gjykata kishte afat deri në dt 25 Korrik 2023 që të shprehej me vendim të gjyqtarit që duhej shortuar ndërkohë që në sistem nuk kishte asnjë gjurmë dhe le më të ishte shortuar gjykatësi dhe të caktohej data e gjyqit.

Në dt 17 Korrik 2023 u paraqit përsëri përfaqësuesi i autorizuar i ShpresON pranë Zyrës së Informacionit të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe përsëri asnjë e dhënë apo gjurmë ku i paralajmëruam për ankesën e parë drejtuar Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë për aktin e paprecedentë.

Lëvizja Politike ShpresON

Në dt 18 Korrik 2023 u paraqit përsëri përfaqësuesi i autorizuar i ShpresON pranë Zyrës së Informacionit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë dhe përsëri nuk kishte asnjë gjurmë dhe për këtë arsye dorëzuam nëpërmjet Postës Ankesën drejtuar Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë.

Në dt 19 Korrik 2023 u paraqitëm përsëri pranë Zyrës së Informacionit dhe përsëri asnjë e dhënë.

Në dt 20 Korrik 2023 u paraqit përsëri përfaqësuesi i ShpresON pranë Zyrës së Informacionit dhe na komunikohet që kërkesa jonë ishte futur në sistem në dt 19 Korrik 2023 (kërkesa datonte tashmë me datën e protokollit në 10 Korrik 2023) dhe ishte bërë shorti ku gjyqtar ishte caktuar Z. Dritan Caka por dosja ende nuk i ishte dorëzuar. Po atë ditë ne kishim dorëzuar pranë KLGJ në protokoll ankesën e dt 18 Korrik 2023.

Në dt 21 Korrik 2023 u paraqit përsërin përfaqësuesi i ShpresON pranë Zyrës së Informacionit dhe na deklarohet se nuk është caktuar asnjë datë gjyqi megjithëse ligji përcaktonte dt 25 Korrik 2023 si ditën e dhënies së vendimit për regjistrim apo kthim për plotësim dokumentacioni.

Në dt 24 Korrik 2023 u paraqit përfaqësuesi i ShpresON përsëri pranë Zyrës së Informacionit dhe na deklarohet se nuk është caktuar asnjë datë gjyqi megjithëse ligji përcaktonte dt 25 Korrik 2023 si ditën e dhënies së vendimit për regjistrim apo kthim për plotësim dokumentacioni.

Dje në dt 25 Korrik 2023 u paraqit përsëri përfaqësuesi i ShpresON pranë Zyrës së Informacionit dhe na deklarohet se nuk është caktuar asnjë datë gjyqi megjithëse ligji përcaktonte datën e sotshme (në dt 25 Korrik 2023 plotësohen 15 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës konform nenit 24 të Ligjit për regjistrimin e OJFve të vitit 2001 dhe Nenit 31 të Ligjit për Regjistrimin e OJFve të vitit 2021) si ditën e dhënies së vendimit për regjistrim apo kthim për plotësim dokumentacioni. Ky fakt verifikohet në sistemin online të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (<https://www.gjykatatirana.gov.al/kendiinformativ/kalendariceshtjeve/ojf/>)

Pra, megjithë interesimin e përditshëm, paraqitjen e 3 ankesave drejtuar të 3 autoriteteve përgjegjëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shkelur me dashje legjislacionin shqiptar duke kryer veprime antikushtetuese dhe këto fakte janë të verifikueshme nga çdo person apo autoritet i interesuar për të mbëedhur fakte mbi këtë precedent të rrezikshëm që i heq qytetarëve shqiptarë një liri kushtetuese të fituara në 8 Dhjetor 1990.

1. Prova: Fotokopje e Neni 46 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË*

(Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.1.2007; nr. 9904, datë 21.4.2008; nr. 88/2012, datë 18.9.2012; nr. 137/2015, datë 17.12.2015; nr. 76/2016, datë 22.7.2016; nr. 115/2020, datë 30.7.2020; nr. 16/2022, datë 10.2.2022)

Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit,

VENDOSIM KËTË KUSHTETUTË:

Neni 46

1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.
2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj.
3. Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit.

2. Prova: Fotokopje e Neni 24 të Ligjit Nr. 8789, datë 7.5.2001



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

L I G J

Nr. 8789, datë 7.5.2001

PËR REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

Neni 24

Vendimi i gjyqtarit

1. Gjyqtari vendos për kërkesat e regjistrimit ose të depozitimit, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës në gjykatë.
2. Në rastin kur gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe të dokumentacionit të bashkëlidhur, gjyqtari vëren se përmbajtja e tyre nuk është e plotë, pasi thërret dhe dëgjon kërkuuesin, vendos për çështjet që duhen plotësuar, duke caktuar edhe një afat të arsyeshëm për plotësimin e tyre.
3. Vendimi për regjistrimin jepet nga gjyqtari edhe në rastin kur një gjykatë tjetër ka marrë vendim për kryerjen e këtij veprimi.

3. Prova: Fotokopje e Neni 31 të Ligjit për regjistrimin e OJFve nr 80 i viti 2021

LIGJ

Nr. 80/2021

PËR REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

Neni 31

Vendimi i gjyqtarit

1. Gjyqtari, me përjashtim të rasteve kur ka pezulluar shqyrtimin e kërkesës sipas nenit 29 të këtij ligji, vendos për kërkesat e regjistrimit ose të çregjistrimit në dhomë këshillimi brenda

13

15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e depozitimit të kërkesës në sekretarinë e regjistrimit ose në formë elektronike.

2. Vendimi për regjistrimin jepet nga gjyqtari edhe në rastin kur një gjykatë tjetër ka marrë vendim për kryerjen e këtij veprimi.

Lëvizja Politike ShpresON

4. **Prova:** Kopje e faqes së parë të **Kërkesës** për Regjistrim të Shoqatës Lëvizja Politike ShpresON në dt 10 Korrik bashkë me vulën e regjistrimit dhe Mandat Pagesën përkatëse.

Kërkesë për Regjistrimin e Shoqatës

U DEPOZITUA K/SEKRETARI
PADITE

10-07-2023 KERKESE

KËRKUESI
Emri
b

12 1976, ve

**Gjykata e Rrethit
Tiranë**

MANDAT

NR. 581

ARKETONI NGA

OBJEKT
SHUMA

ME FJALË, LEKË

PER
FINANCIERI

Shoqata

AR

Në mbështetje të ligjit 8788 datë 07.05.2007
Regjistrimin e Organizatave JoFitimprurëse është the
ShpresON" në dt 5 Korrik 2023 dhe e vërtetuar nga n
06.07.2023

Lëvizja Politike ShpresON

5. Prova: Kopje e faqes së parë të Ankesës të paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dt 14 Korrik 2023 bashkë me vulën e protokollit 4296

Drejtuar:
Z. Donald Xhelili
Kancelar Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë

Për dijeni:
Z. Flamur Kapllani
Kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë

Lënda:
ANKESË
për bllokim dhe fshehje të qëllimtë nga ana e Sekretarisë së Gjykatës të kërkesës për regjistrim të Shoqatës Lëvizja Politike ShpresON duke mos hedhur të dhënat në sistemin elektronik të Gjykatës dhe duke penguar hedhjen e shortit dhe pengimin artificial të plotësimit të afatit detyrues 15 ditor që përcakton ligji për dhënien e vendimit për regjistrim (apo kthim dokumentacioni) nga ana Gjykatës.

Dërgon:
Endrit Reka
në cilësinë e Kërkuarit për regjistrim të Shoqatës Lëvizja Politike ShpresON
Adresa: Rruga Bardhok Biba, Galeria, Hyrja A, Apt 51, Tiranë.
E-mail: endritreka@gmail.com **Tel:** +355696876284

Baza Ligjore:
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
Kodi Civil
Kodi i Proçedurës Civile
Ligji Nr. 8788 për Organizatat JoFitimprurëse dt. 07.05.2001 (i ndryshuar)
Ligji për Regjistrimin e Organizatave JoFitimprurëse Nr. 80/2021 (Ligjit Nr.8789 dt. 07.05.2001 "Për Regjistrimin e OJF").

Tiranë 14 Korrik

I nderuar Z. Kancelar,

Po ju paraqes këtë ankesë në cilësinë e Kërkuarit dhe në emër të 12 themeluesve të Shoqatës Lëvizja Politike ShpresON në lidhje me një veprim antiligjor të kryer nga Sekretaria e Gjykatës dhe që cënon rëndë të drejtat kushtetuese të shtetasve për tu organizuar (përkatësisht nga **Neni 46** i Kushtetutës).

Bazuar në Legjislacionin Shqiptar dhe konkretisht në Kodin Civil, Kodin e Proçedurës Civile, Ligjin për OJF dhe sidomos në Ligjin për Regjistrimin e Organizatave JoFitimprurëse Nr. 80/2021 (Ligji Nr.8789 dt. 07.05.2001 "Për Regjistrimin e O.J.F"), kemi paraqitur në Sekretarinë e kësaj Gjykate Kërkesën bashkë me dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit për regjistrim në 10 Korrik (kemi edhe kopjen me vulën e gjykatës) dhe kemi paguar mandatin me nr 581 të dt 10 Korrik në sportelin e arkës së kësaj gjykate.

Në kërkesën tonë në faqen e fundit i kemi kujtuar Gjykatës se

Lëvizja Politike ShpresON

6. **Prova:** Kopje e faqes së parë të **Ankesës** të paraqitur në Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë dt bashkë me faturën postare dhe kopjen e letërporosisë së postës që konfirmon marrjen.

Lëvizja Politike Shp													
Drejtuar: Këshillit të Lartë Gjyqësor: Znj. Naureda Llagami, Kryetare Z. Ilir Rusi, Zv.Kryetar Z. Alban Toro, Anëtar Znj. Brikena Ukperaj, Anëtare Z. Ridvan Hado, Anëtar Z. Dritan Hallunaj, Anëtar Znj. Yllka Rupa, Anëtare Znj. Fatmira Luli, Anëtare Z. Klodian Kurushi, Anëtar Znj. Marçela Shehu, Anëtare Znj. Irena Plaku, Anëtare Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë: Z. Artur Metani	Ir: EFTESË RANIMI E OBJEKTIVE POSTARE Objekti Letra OD-BAR RR449852415AA erguesi ALTIN GOXHAJ larresi INSPEKTORIATI I LARTE I DREJTESISË end Mbërritja TIRANA esha 75 gr M RR449852415AA <table><tr><td>herblime te vecanta</td><td>50</td></tr><tr><td>M ne postim</td><td></td></tr><tr><td>arifa Shtese</td><td>50</td></tr><tr><td>arifa Postare</td><td>85</td></tr><tr><td>arifa Totale</td><td>135</td></tr><tr><td>lenshkrimi:</td><td>Lejla Koci</td></tr></table>	herblime te vecanta	50	M ne postim		arifa Shtese	50	arifa Postare	85	arifa Totale	135	lenshkrimi:	Lejla Koci
herblime te vecanta	50												
M ne postim													
arifa Shtese	50												
arifa Postare	85												
arifa Totale	135												
lenshkrimi:	Lejla Koci												
Për dajeni: Z. Donald Xhelili, Kancelar Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë Z. Flamur Kapllani, Kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë													
Për dajeni: <ul style="list-style-type: none">• Institucioneve ndërkombëtare dhe përfaqësive diplomatike të përfshira në mbështetjen e hartimit të Reformës në Drejtësi dhe të atyre që po mbështesin zbatimin e kësaj Reforme• Organizatave lokale dhe ndërkombëtare që mbrojnë Lirinë dhe të Drejtave të Njeriut dhe atyre që mbështesin demokracinë dhe pjesmarrjen publike në vendimarrje• Mediave lokale dhe atyre ndërkombëtare• Organizatave politike të djathta në Europë dhe SHBA													
Lënda: ANKESË për bllokim dhe fshehje (apo zhdukje) të qëllim të (apo dhe me urdhër politik nga jashtë Sistemit Gjyqësor) nga ana e Sekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të kërkesës (dhe dokumentave shoqëruese) për regjistrim të Shoqatës Lëvizja Politike ShpresON duke mos hedhur të dhënat e kërimit në sistemin elektronik të Gjykatës dhe duke penguar për pasojë edhe hedhjen e shortit dhe pengimin artificial të plotësimit të afatit detyrues 15 ditore që													
Selia: Rr. Bardhok Biba, P.75, Sh.2, Nr 5, (Kati i Parë) Tiranë, Shqipëri	1												

Lëvizja Politike ShpresON

7. Prova: Kopje e faqes së parë të Ankesës së paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dt bashkë me vulën dhe nr e protokollit

Lëvizja Politike ShpresON

Drejtuar:

Këshillit të Lartë Gjyqësor:
Znj. Naureda Llagami, Kryetare
Z. Ilir Rusi, Zv.Kryetar
Z. Alban Toro, Anëtar
Znj. Brikena Ukperaj, Anëtare
Z. Ridvan Hado, Anëtar
Z. Dritan Hallunaj, Anëtar
Znj. Yllka Rupa, Anëtare
Znj. Fatmira Luli, Anëtare
Z. Klodian Kurushi, Anëtar
Znj. Marçela Shehu, Anëtare
Znj. Irena Plaku, Anëtare


Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë:
Z. Artur Metani

Për dijeni:
Z. Donald Xhelili, Kancelar Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë
Z. Flamur Kapllani, Kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë

Për dijeni:

- Institucioneve ndërkombëtare dhe përfaqësive diplomatike të përfshira në mbështetjen e hartimit të Reformës në Drejtësi dhe të atyre që po mbështesin zbatimin e kësaj Reforme
- Organizatave lokale dhe ndërkombëtare që mbrojnë Lirinë dhe të Drejtave të Njeriut dhe atyre që mbështesin demokracinë dhe pjesëmarrjen publike në vendimarrje
- Mediave lokale dhe atyre ndërkombëtare
- Organizatave politike të djathta në Europë dhe SHBA

Lënda:
ANKESË
për bllokim dhe fshehje (apo zhdukje) të qëllim të (apo dhe me urdhër politik nga jashtë Sistemit Gjyqësor) nga ana e Sekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të kërkesës (dhe dokumentave shoqëruese) për regjistrim të Shoqatës Lëvizja Politike ShpresON duke mos hedhur të dhënat e kërimit në sistemin elektronik të Gjykatës dhe duke penguar për pasojë edhe hedhjen e shortit dhe pengimin artificial të plotësimit të afatit detyrues 15 ditor që



Donëzuar klgj
dt. 19.07.2023
[Signature]

Selia: Rr. Bardhok Biba, P.75, Sh.2, Nr 5, (Kati i Parë) Tiranë, Shqipëri

1

Lëvizja Politike ShpresON

8. **Prova:** Foto nga **websiti** i Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë që tregon se Gjyqtari Dritan Caka nuk ka lënë as datë dhe as ka zhvilluar ndonjë seancë gjyqësore për kërkesën për regjistrimin e Shoqatës “Lëvizja Politike ShpresON”.

The screenshot displays the website of the Albanian Judicial System (gjykatatirana.gov.al). The main content area is titled "Lista e seancave gjyqësore" (List of judicial sessions). The search criteria are as follows:

- Nr. çështjes (Case Number): [Empty field]
- Kodi i Anonimizimit (Anonymization Code): [Empty field]
- Gjyqtari (Judge): Dritan Caka
- Lloji i Çështjeve (Type of Case): Regjistrim Fillestar (First Instance Registration)
- Prej (From): 10 Jul 2023
- Deri (To): 25 Jul 2023

The search results show "Nuk u gjetën rezultate për këtë kërkim" (No results found for this search). The left sidebar contains navigation links: Kalendari i çështjeve, Çështje në gjykim, Evidencat statistikore, Evidencat statistikore specifike, Njoftimi me Afishim Publik, Sondazhe mbi gjykatën, Njoftime, Aktivitete, and Vende.

<https://docs.google.com/document/d/1fPcT6raCvr9kO9hzpALQpgWZTiJzb5VbV2JTJ62N2-A/edit>